

## AKT THEMELIMI

### **“PENSAN AURORA ALBANIA” SH.P.K**

(Shoqëri me ortak të vetëm)

Sot, më datë 06/04/2022, (dymijë e njëzetedy) në Tiranë:

- 1. Znj Aurora HADERAJ** e datëlindjes 12/01/1988, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasaportë Nr. BG3178350 dhe ID I85112050J

Me anë të këtij Akti Themelimi, themelon një shoqëri të zotëruar tërësisht prej saj, në Republikën e Shqipërisë, si vijon:

#### **1. THEMELIMI**

- 1.1** Themelimi në Republikën e Shqipërisë të shoqërisë me emër **“PENSAN AURORA ALBANIA” Sh.p.k (“Shoqëria”)**. Ky emërtim do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.
- 1.2** **“PENSAN AURORA ALBANIA” Sh.p.k** është një shoqëri tregtare dhe person juridik shqiptar, e organizuar ligjërisht si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k), në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe dispozitat e statutit aktual të saj (**“Statuti”**).
- 1.3** Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga **“Mujo Ulqinaku”**, Njesia Administrative Nr.10, Pallati 10 Hyrja 38, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe /apo në një qytet tjetër të Shqipërisë.
- 1.4** Më vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë zyra përfaqësie, degë ose të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

1.5 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar duke nisur nga regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## **2. OBJEKTI I SHOQËRISË**

2.1 Objekti shoqërisë është si vijon: Tregtimi me shumice e pakice i mallrave të ndryshëm industriale, veshmbathje e kancelari.

## **3. KAPITALI THEMELTAR**

2. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 ( njëqind) Lekë e përbërë nga 1 (një) kuotë e vetme e zotëruar tërësisht nga Ortaku i vetëm nga **Znj Aurora HADERAJ**, e datëlindjes 12/01/1988, shtetase shqiptare, lindur në Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasaportë me Nr. BG3178350

## **4. ORGANET VENDIMARRËSE TË SHOQËRISË**

4.1 Organet vendimarrëse të Shoqërisë janë:

- i. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve,
- ii. Administratori/ët

## **5. ASAMBLEJA E PËRGJITHSME E ORTAKËVE**

5.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila përbëhet nga Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, i cili merr vendime mbi aktivitetin dhe politikën ekonomike dhe tregtare të saj.

## **6. ADMINISTRATORI**

6.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 ( nje) administrator, e cila do të jete përfaqësuese ligjore e shoqërisë dhe përfaqëson atë kundrejt palëve të treta dhe do të jete përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve të përditshme të shoqërisë, duke iu nënshtuar kufizimeve të parashikuara në statutin e shoqërisë dhe në ligjin e aplikueshëm.

6.2 Administrator i shoqërisë është:

1. **Znj Aurora HADERAJ**, e datëlindjes 12/01/1988, shtetase shqiptare lindur në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasaportë me Nr. BG3178350

e cilia ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e saj pa kufizim.

- 6.3 Kohëzgjatja e emërimit të administratori të Shoqërisë do të jetë 5 ( pese) vjet, nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me të drejtë ripërtëritje.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 5 ( pese) kopje origjinale identike në gjuhën shqipe.

**PËR ORTAKUN E VETËM**

**Aurora HADERAJ**

Aurora Hadëraj  
